

VENDIM
Nr. 1064, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT E EFICIENCËS PËR
BOJLERËT E UJIT QË PËRDORIN LËNDË DJEGËSE TË LËNGËT OSE TË
GAZTË”¹ DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 2, e 42, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e eficiencës për bojlerët e ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të bojlerëve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të bojlerëve me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Direktiva e Këshillit Evropian 92/42/EEC, e datës 21 maj 1992, “Mbi eficiencën e bojlerëve me ujë të nxehtë që përdoren me gaz”, ndryshuar nga direktiva 2008/28/EC, numri Celex 31992L0042; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 167, datë 22.6.1992, faqe 17–28.